



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupstina Glavnog Grada –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18.5.2023, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahim, Kimeta Shok, Nenad Miladinovic, Oktay Kurtesh, Faton Marolli.

Munguan: Elmira Nikçi - Rexha, Tiera Kasumi, Adnan Ajeti.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Lulzim Vrapca, zyrtar nga Drejtoria e Arsimit, Klaudia Mula, zyrtare e ZKKK-së, Adelinë Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Premtime Preniqi, zyrtare për Barazi Gjinore, Fisnik Dida - përfaqësues nga OSBE-ja, përfaqësuesit e KFOR-it, Arianita Beqa - Rraci, përfaqësuese nga UNMIK-u.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj Besianë Musmurati;
3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelinë Sahiti, të na raportojë lidhur me numrin e rasteve sociale nga ana e komuniteteve joshumicë (serbë, goranë, turq, boshnjakë, romë dhe ashkali);
4. Ftesë për zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Premtime Preniqi, të na raportojë lidhur me sfidat dhe projektet për vitin 2023;
5. Formimi i Grupit për vizitë në lagjet e komuniteteve joshumicë: Bërnice e Poshtme, Bërnice e Epërme, Bardhosh, Leban, Besi, dhe Slivovë, njoftim i informatave relevante të kërkesave të vendasve, si dhe informim lidhur me kërkesat për projekte;
6. Raporti i ZKKK-së për muajin prill 2023;
7. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati

Mirsada Behluli - për shkak të pamundësisë së pjesëmarrjes në takim të drejtoreshës së arsimit znj. Musmurati, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës do të na njoftojë z. Lulzim Vrapca, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit.

Lulzim Vrapca - tha se sa i përket procesit të shkollimit të komuniteteve joshumicë i kemi kushtuar rëndësi të veçantë rekrutimit të mësimeve të reja që vijnë nga komuniteti joshumicë si në shkollën fillore "Elena Gjika", "Naim Frashëri", në Shkollën e mesme të mjekësisë "Ali Sokoli". Ai në vazhdim tha se edhe përkundër faktit që janë plotësuar ato kriteret e caktuara që i parasheh normativi sa i përket mësimeve të komunitetit boshnjak dhe turk për shkak të numrit të konsiderueshëm të nxënësve të kenë mësimeve në gjuhën e tyre. Ndërsa sa i përket rasteve sociale të cilat janë në gjendje të rëndë sociale ne si drejtori jemi munduar t'i adresojmë përmes organizatave të ndryshme, edhe sa herë që ato kanë pasur nevojë për ndihmë ne i kemi përkrahur, së bashku me KFOR-in italian, e me të cilin në vazhdimësi kemi pasur dhe kemi koordinim të mirë në këtë drejtim, veçanërisht tek nxënësit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, në shkollën "Emin Duraku" dhe "AsimVokshi". Kurse sa i përket braktisjes së shkollimit tha se braktisja e shkollimit është një fenomen që i përket jo vetëm një komuniteti të caktuar etnik, por është një fenomen i përgjithshëm i krejt komuniteteve, dhe rrjedhimisht janë trajnime të caktuara për rehabilitimin e tyre dhe kthimin e tyre në procesin mësimor, në ç' rast faza e parë është identifikimi, pastaj socializimi i tyre dhe takimi i prindërve që zhvillohet nga drejtuesit e shkollës, nga psikologu, pedagogu, drejtori i shkollës, lidhur me arsyetimin se për çfarë arsye është braktisur shkolla.

Mirsada Behluli - shtroi pyetje se a ka probleme me mjete shkollore në gjuhën boshnjake pasi që në fillim ka pasur dhe a janë rregulluar ato.

Lulzim Vrapca - lidhur me pyetjen e znj. Behluli tha se kjo është kompetencë ekskluzive e Ministrisë së Arsimit, kurse ne si drejtori realisht e bëjmë shpërndarjen, furnizimin me tekste shkollore në arsimin fillor dhe të mesëm.

Kimeta Shok - shtroi pyetje se në çfarë niveli është siguria e fëmijëve dhe a është duke u ndërmarr diçka për sigurinë e tyre pasi që shpeshherë po ndodhin përleshje në mes nxënësve, ku ka raste që përdoren edhe thikat.

Lulzim Vrapca - duke iu përgjigjur znj. Shok, tha se dje së bashku me drejtoreshën kemi pasur takim në Zyrën qendrore të policisë me drejtorin e policisë, kështu që edhe plani operativ i Policisë së Kosovës i ka paraparë disa aktivitete të përbashkëta me Drejtorinë e Arsimit. Ai në vazhdim tha se nuk e di se sa jeni të njoftuar, ne si Komunë jemi në finalizim të Planit të veprimit për siguri në shkolla, ku në fillimin e vitit shkollos 2023/2024 do ta keni

këtë plan, i cili parasheh aktivitete të ndryshme, ku një prej aktiviteteve që e kemi përmendur me Policinë e Kosovës ka qenë kontrollimi sporadik, ku ne mundemi ta ftojme policinë në shkollë dhe ta bëjë një kontrollim të nxënësve në ato shkolla që dyshohet se mund të ketë përdorim të lëndëve narkotike.

Mirsada Behluli – tha se ka qenë një vërejtje në shkollën “Xhevdet Doda” tavanet kanë qenë të dëmtuara, ku nxënësit kanë qenë në rrezik dhe a është sanuar ai problem.

Lulzim Vrapca - tha se kemi shumë kërkesa të tilla të cilat na i adresojmë, meqë për momentin nuk e di se kur ka ndodhur kjo dhe nuk jam i gatshëm t’ju them se a është bërë apo jo sepse është një fluks i madh i kërkesave njëjavore që ne i përcjellim, mirëpo besoj që është rregulluar.

Oktay Kurtesh – shtroi pyetje se a ka mundësi që në Kopshtin e fëmijëve “Yllkat”, të zgjatet qëndrimi i fëmijëve deri në moshën pesëvjeçare, pasi që është vetëm deri në moshën trivjeçare.

Lulzim Vrapca - tha se ne jemi duke e marrë planifikimin tash edhe të shohim, edhe përderisa janë vendet e zëna, thjesht kur nuk ka shtretër dhe hapësirë dhe përderisa nuk ka pasur një projektion të tillë të numrit të regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore, ka ndodhur një mbingarkesë tek “Yllkat”.

Nenad Miladinovic – duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit, veçanërisht përshëndes z. Lulzim Vrapca, me të cilin kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë, ku besoj se ai bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje.

Pika e tretë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelinë Sahiti, të na raportojë lidhur me numrin e rasteve sociale nga ana e komuniteteve joshumicë (serbë, goranë, turq, boshnjakë romë dhe ashkali).

Mirsada Behluli – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia jap drejtoreshës të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale znj. Adelinë Sahiti, që të na njoftojë lidhur me numrin e rasteve sociale nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Adelinë Sahiti – sa i përket pyetjeve që më janë dërguar tha se rastet sociale të cilat përfitojnë ndihmë në Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë prijnë dy komunitetet, ato janë komuniteti ashkali dhe komuniteti serb, ku tek komuniteti ashkali janë 49 familje me 209 anëtarë që janë skemë e pjesës sociale dhe përfitues të asistencës sociale. Tek komuniteti serb i kemi nëntë familje me 34 anëtarë, kurse tek komuniteti rom i kemi dy familje të cilat i kanë pesë anëtarë, tek komuniteti turk e kemi një familje me dy anëtarë, ndërsa tek komuniteti boshnjak, goran dhe egjiptian nuk kemi asnjë familje të skemës sociale. Ja pra, kjo është pasqyra e gjendjes të cilën e kemi aktualisht, ku neve na gëzon fakti se ka disa prej komuniteteve që nuk kanë fare raste të skemës sociale. Mirëpo në anën tjetër na brengos fakti që tek komuniteti ashkali kemi diku 49 familje, numër që është relativisht i lartë duke e pasur parasysh se nuk kemi edhe aq

familje të këtij komuniteti në kryeqytet. Por mund t'ju informoj se ajo çka po bëjmë ne si kryeqytet është se jemi duke i hartuar politikat që të zbresim sa më shumë numrin e rasteve sociale, duke i integruar në tregun e punës, dhe këtë normalisht e bëjmë duke i dërguar në aftësim profesional, trajnime të ndryshme dhe sa herë që kemi ndonjë kërkesë prej ndonjë biznesi privat, ne me kënaqësinë më të madhe ju ofrojmë atyre që t'i largojmë nga skema sociale. Ajo në vazhdim tha se e rëndësishme është që të kemi edhe bashkëpunimin me juve Komitetin për Komunitete dhe të gjitha komunitetet e përfaqësuara në të, që t'i lihet hapësirë ku janë rastet dhe çka ne mund të intervenojmë përveç këtyre statistikave që i prezantova. Ajo mes tjerash tha se e kemi të nevojshme që të na kontaktoni, të na ftoni që të shohim së bashku se si mund ta bëjmë zgjidhjen më të mirë të mundshme që ta integrojmë secilin komunitet e të ndihen të barabartë me komunitetin shumicë.

Mirsada Behluli - duke u ndërlidhur me rastin e një numri të punëtorëve të cilët janë me kontratë të punës, pikërisht në Llotarinë e Kosovës të cilët kanë mbetur pa punë, shtroi pyetje se a mund të na thoni diçka për situatën e tyre pasi që ata nuk marrin kurrfarë kompensimi.

Adelinë Sahiti - duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se ndoshta duhet të shkohet përmes Zyrës së komuniteteve apo kabinetit të Kryetarit e pastaj të procedohet tek menaxhmenti i RTK-ës, ku ata me siguri do t'ju japin një përgjigje.

Kimeta Shok - shtroi pyetje se a ekziston ndonjë ndihmë e njëhershme për personat me sëmundje malinje, siç kanë qenë më herët.

Adelinë Sahiti - lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Shok tha se i kemi tek Drejtoria e Shëndetësisë kopjet e sëmundjeve si ato malinje ashtu edhe kronike, pasi që kemi kërkesa të shumta nga qytetarët me asistencë sociale, ose me aftësi të kufizuar.

Nenad Miladinovic - tha se kisha me u nisur nga ndihma e njëhershme e cila ka të bëjë për njerëzit e sëmurë dhe ata të cilët janë të cenuar. Ai në vazhdim tha se në të kaluarën kam bashkëpunuar shumë me drejtorin e atëhershëm të Shëndetësisë z. Arben Vitia ku dhe kemi gjetur zgjidhje si t'i përfshijmë sa më shumë familje me atë ndihmë. Veçanërisht kemi qenë të fokusuar në ata njerëz të cilët kanë qenë të sëmurë nga sëmundjet malinje ku dhe aty ka qenë ndihma më e madhe. Meqë i kemi përfshirë edhe ata njerëz që janë të sëmurë nga sëmundjet e tjera e që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten, besoj se edhe tani duhet të veprojmë njëjtë, pasi që përdorin barna të shtrenjta për të cilat ju vyen ndihma. Pra është me rëndësi që të keni parasysh që të hyjë në rregullore edhe kjo që të përfshihen edhe familjet tjera. Ai mes tjerash tha se tani do isha fokusuar në ngrohjen për familjet që janë të cenuara, si dhe mendoj se sa ju keni ndonjë lëshim aty, aq më shumë ne si komitet kemi, pasi që ne jemi të detyruar që të ju dorëzojmë juve listën me emrat e familjeve me të gjitha të dhënat që kanë nevojë për ndihmë sociale që mos të vjen deri tek gabimet. Pasi që edhe vitin e kaluar kemi pasur disa familje të cilat nuk kanë marrë ndihmë ku në disa raste ajo ka ndodhur në rastet që me të vërtetë kanë nevojë.

Mirsada Behluli - sa i përket listave do ju kisha preferuar që mos të bazoheni në listat e vjetra, por të bazoheni në listat e reja pasi që po vjen deri tek ndryshimi i të dhënave si p.sh tek xhirollogaritë ku më së shumti aty bëhen gabimet që nuk mund i marrin ndihmat.

Adelinë Sahiti - sa i përket ndihmës me dru për ngrohje tha se për herë të parë kryetari Rama i ka përfshirë të gjitha familjet për t'ju ndihmuar me dru për ngrohje pa dallim, gjë që ne e kemi planifikuar vetëm për rastet sociale, siç e kemi bërë me familjet shqiptare.

Mirsada Behluli - tha se pasi që ka lindur problemi, meqë kanë qenë vetëm tridhjetë e sa, unë e kam njoftuar direkt Kryetarin e komunës ashtu që ka qenë i informuar.

Adelinë Sahiti - tha se kur jemi tek kthimet dhe numrat e xhirollogarive është problem të cilin e kemi pasur edhe në vitin e parë të qeverisjes kur kemi ardhur, i kemi pasur nga 300 kthime që është një numër enorm dhe se ministria na i ka kthyer dhe nuk ka mundur t'i ekzekutojë ato para. Po ashtu edhe këtë vit kemi 100 kthime diku 150 - 170 nuk jam e sigurt, por zyrtarja jonë e financave është duke biseduar dhe besoj se deri tash e ka përfunduar punën në ministri, që për me ju dërguar sërish xhirollogaritë se është dashur të korrigojen një nga një. Unë tash vetëm mund t'i bashkohem znj. Mirsadë se duhet pasur kujdes ju si përfaqësues të komuniteteve që kur të merren emrat dhe të dhënat të jenë të sakta e mos të na dalin probleme të tilla. Ndërsa sa i përket ndihmave të njëhershme si p.sh tek sëmundjet malinje, pse nuk po shtohen edhe kategoritë e tjera dhe pse ne si drejtori nuk po mund t'i mbështesim ato. Ju përmendet z. Arben Vitia që ka qenë drejtor në të kaluarën dhe tani është ministër, këtu vetëm një gjë duhet ta dini dhe ta keni parasysh se ai ka qenë drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku në vitin 2018 këto dy drejtori janë ndarë, dhe Drejtoria e Shëndetësisë prapë vazhdon me dhënë ndihma për të sëmuret me kancer, me diabet, kurse ne vazhdojmë ta mbështesim aftësinë e kufizuar dhe rastet sociale.

Pika e katërt

Ftesë për zyrtaren e Zyrës për Barazi Gjinore - znj. Premtime Preniqi, të na raportojë lidhur me sfidat dhe projektet për vitin 2023

Premtime Preniqi - tha se si zyrtare për koordinimin e të drejtave të njeriut nuk kam buxhet. Do të thotë e gjithë puna që bëhet është falë asaj që kam një bashkëpunim shumë të mirë me organizatat ndërkombëtare, ku dhe njëherazi jam e trajnuar si trajnere për barazi gjinore dhe për të drejtat e njeriut. Pra bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare ka filluar prej OSBE-së, UNDP-së, Save the Children etj., me të cilat arrij t'i realizojë fushatat dhe projektet. Sa i përket organizatave joqeveritare vendore me të cilat kam bashkëpunim, është organizata e grave të komuniteteve romë, shkali dhe egjiptian, gjithashtu kam bashkëpunuar edhe me organizatat e komunitetit serb si me organizatën "Ruka ruci", kështu që i gjithë ky bashkëpunim me këto organizata ka ndikuar në pozitivitetin e realizimit të punës me komunitetet. Ajo në vazhdim tha se në kuadër të punës sime kemi edhe mekanizmin koordinues kundër dhunës në familje, ku në këtë mekanizëm janë të përfshirë krejt institucionet e Kosovës të cilat merren me këtë lëmi, pra dhunën në familje dhe disa organizata joqeveritare. Gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave që i bëjnë qytetarët në kuadër të këtij grupi është dhuna në familje ku përfshihen të gjitha komunitetet, ndërsa

pjesë të shqyrtimeve të cilat dikush nga komunitetet joshumicë kanë nevojë për strehim, atëherë strehimorja është në Novo Bërdë, strehimorja e grave e cila i kushtohet komunitetit serb, si dhe është edhe strehimorja në Prishtinë ku përfshihen më shumë komunitete. Përveç kësaj si pjesë të punës e kam edhe asamblenë komunale të fëmijëve ku bëjnë pjesë fëmijët prej klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë. Aty përveç komunitetit shumicë është i përfaqësuar edhe komuniteti turk, i cili i ka përfaqësuesit e vet dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Ajo mes tjerash tha se shumicën e aktiviteve i organizoj pa buxhet, në shumicën e rasteve dalim edhe në terren ku bisedojmë me qytetarët, pastaj kemi edhe takimet të cilat i mbajmë nëpër shkolla, si dhe më duhet të them se kjo është një zyrë e cila merret edhe me pjesën e komuniteteve.

Mirsada Behluli - shtroi pyetje se a keni informata se kush është provokues i dhunës në familje pasi që gjithnjë konsiderohet se provokues i dhunës është gjinia mashkullore, po mendoj dhunës fizike, pasi nga ana psikike provokuese e dhunës në familje mund të jetë edhe gjinia femërore.

Premtime Preniqi - tha se kur është në pyetje dhuna në familje pa marrë parasysh se kush e provokon atë dhunë, është shumë e papranueshme. Janë mënyrat tjera të zgjidhjes së problemit, mirëpo edhe përkundër asaj prapëseprapë ajo nuk është një faktor që e shkakton dhunën.

Pika e pestë

Formimi i Grupit për vizitë në lagjet e komuniteteve joshumicë : Bërnice e Poshtme, Bërnice e Epërme, Bardhosh, Leban, Besi, dhe Slivovë, njoftim i informatave relevante të kërkesave të vendasve, si dhe informim lidhur me kërkesat për projekte

Nenad Miladinovic - tha se kryesisht ato vizita i organizon ZKKK-ës, ku Sllavica e kryen vizitën.

Klaudia Mula - tha se këto fshatra i takojnë zakonisht qytetarëve të komunitetit serb, Nenadi pasi që është përfaqësues i komunitetit serb e di se çka është më e arsyeshme ose jo dhe të gjitha problemet e këtij komuniteti i ka sjell në takim qoftë edhe kërkesat me shkrim, qoftë edhe verbalisht. Ne si zyrë jemi të hapur të marrim pjesë në çdo vizitë në terren, por prapë ju vendosni.

Nenad Miladinovic - sa i përket vizitës së familjeve tha se do të ishte mirë që të vizitohen ato familje të cilat jetojnë të vetme dhe në kushte të vështira. Pas ca diskutimesh dhe propozimesh për anëtarë të Komisionit për vizitë në lagjet e komuniteteve joshumicë: Bërnice e Poshtme, Bërnice e Epërme, Bardhosh, Leban, Besi, dhe Slivovë u propozuan Sllavica Stolic, Kimeta Shok dhe Arianita Beqa Rraci - përfaqësuese e UNMIK- t.

Pika e gjashtë

Raporti i ZKKK-ës për muajin prill 2023

Klaudia Mula - në pika të shkurta të pranishmit i informoi lidhur me punën dhe aktivitetet e ZKKK-ës për muajin prill.

Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-ës për muajin prill 2023.

Pika e shtatë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre

Nenad Miladinovic - sa i përket sigurisë tha se nuk kemi probleme të asaj natyre. Mirëpo nuk e di se për të satën herë edhe sot më duket se do të jetë hera e fundit që do t'i drejtohem organeve komunale që nëse organet komunale nuk ndërmarrin asgjë lidhur me deponitë ilegale në Bërniceën e Poshtme, sepse kjo është hera e gjashtë apo e shtatë që e paraqes këtë problem dhe asgjë nuk ndërmerret, kurse kam vendosur që në takimet e ardhshme pakënaqësinë time ndaj organeve komunale ta shprehim me heshtje. Me të vërtetë nuk ka kuptim që nëse dikush e paraqet një problem gjashtë muaj radhazi e askush nuk intervenon, kjo nuk ka ndodhur asnjëherë. Unë jam këtu që dhjetë vite në këtë komitet edhe në njëfarë mënyre jam i kyçur në punën e pushtetit vendor, se kjo që po ndodh në Bërniceën e Poshtme për momentin rrezikon sigurinë, jetët e njerëzve, e të gjithëve. Ky nuk është problem vetëm i komunitetit serb, por i të gjithëve që jetojnë aty. Ai në vazhdim tha se kisha me e lutur komisionin e posaformuar që së pari ta vizitojnë atë pjesë ku hedhet ajo deponi dhe ta bëjnë raportin pasi që ajo është shumë me rëndësi.

Ai mes tjerash cekti edhe çështjen e qenve endacakë, ku komuna duhet të punojë edhe në këtë drejtim.

Mirsada Behluli - duke ju drejtuar të pranishmëve tha se nëse jeni të pajtimit që edhe njëherë ta ftojme drejtorin e Shërbimeve Publike për takimin e radhës.

Oktay Kurtesh - sa i përket sigurisë nuk kemi probleme, vetëm se kam ankesa nga komuniteti turk se nuk po mund të marrim dokument dëshmues që janë të komunitetit turk, të cilin gjithnjë e kanë marrë në Komunë, kurse tani ju është thënë se më në Komunë nuk mund ta marrim.

Pika e tetë

Të ndryshme

Mirsada Behluli - të pranishmit i informoi se drejtori i Drejtorisë së Sigurisë z. Lulzim Fushtica ka shprehur dëshirën që të marrë pjesë në njërin prej takimeve tona, prandaj desha t'ju pyes se a jeni të pajtimit ta ftojme për mbledhjen e radhës apo në njërin prej takimeve të tjera.

Takimi i radhës do të mbahet më dt. 19.6.2023.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

Faqe 7 nga 7

